



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:008986
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05831390

K.Dh.Shk.II.nr.1112/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit-propozuesit “Parajsa”Sh.p.k, me numër të biznesit 810196833 me seli në Magjistralen Ferizaj-Shkup, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Marigona I.Gashi avokate nga Prishtina, kundër kundërshtarit të sigurimit Komuna e Lipjanit-Kuvendi Komunal, të cilën me autorizim e përfaqëson Behar Krasniqi, për shkak të caktimit të masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit, të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.204 /2024, i datës 03.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.18.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditësit-propozuesi “Parajsa”Sh.p.k me seli në Magjistralen Ferizaj-Shkup, ndërsa VËRTETOHET Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Ekonomike, KE.nr.204 /2024, i datës 03.05.2024.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim:

“I.REFUZOHET si i pabazuar propozimi i paditësit-propozuesit “Parajsa”Sh.p.k, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe t’i ndalohet të paditurës-kundërshtares së sigurimit Komuna e Lipjanit-Kuvendi Komunal, konfeskimi dhe ekzekutimi i sigurimit të ekzekutimit të tenderit në vlerë prej 33, 602.00 euro sipas kontratës me nr.identifikues 613-23-4034-1-1 e datës 07.07.2023 me titull “Llot-2 ndërtimi i shtratit të lumit në fshatin Smallushë, faza e II-të, pranë Kompanisë së Sigurimeve ‘ELSIG’ sh.a dhe atë deri në zgjedhjen definitive të kontestit sipas padisë me aktgjykim të formës së prerë.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqit propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, duke i propozuar Dhomës së Shkallës së Dytë që të aprovojë ankesën si të bazuar të anulohet aktvendimin KE.nr.204/24, i datës 03.05.2024, dhe çështjen ta kthej në rigjykim, ose aktvendimin e ankimuar të ndryshoj ashtu që të aprovohet si e bazuar kërkesa për caktimin e masës së sigurisë.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitë kundërshtari i masës së sigurisë edhe pse të njejtën e ka pranuar me datën 24.05.2024.

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:
Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i masës së sigurisë “Parajsa”Sh.p.k, me seli në Magjistralen Ferizaj-Shkup, me datën 10.04.2024 pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur padi, njëherit ka paraqit edhe propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit Komuna e Lipjanit-Kuvendi Komunal, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë dhe t’i ndalohet konfeskimi dhe ekzekutimi i sigurimit të ekzekutimit

të tenderit në vlerë prej 33,602.00euro deri në zgjedhjen definitive të kontestit sipas padisë me aktgjykim të formës së prerë.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, me aktvendim, e ka refuzuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, me arsyetim se propozuesi nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së sigurisë të njëjtit do t'i pamundësohet apo vështësohet realizimi i të drejtës subjektive sipas padisë për kompensimin e dëmit për shkak të kundërligjshmë të kontratës. Deri te ky vlerësim gjykata e shkallës së parë ka ardhë pasi që propozuesi nuk ka arritur të argumentojë për gjykatën se cili do të ishte rreziku konkret i pamundësisë së realizimit të kërkesës së tij si në padi në rast se garancioni bankar eventualisht ekzekutohet nga ana e të paditurës, konkretisht çfarë pasoja do sjell ky ekzekutim i garancionit në të drejtat e palës propozuesi sipas padisë. Ndër të tjera ka cek se në rastin konkret si palë e paditurë paraqitet një organ shtetëror e cila nuk mund të shuhet e as t'i nënshtrohet ndonjë procedure të falimentimit nga e cila do të rrezikohej realizimi i kërkesës së propozuesit, andaj nuk ekziston asnjë rrezik që paditësi në të ardhmen të mos mund ta realizojë kërkesën e tij për kompensim dëmi, në rast se kërkesëpadia e tij rezulton si e bazuar. Krejt në fund ka cek se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 297.1 a) dhe b) të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke shqyrtuar ankesat e propozuesit të masës së sigurisë brenda kufijve, gjeti se propozuesi "Parajsa" Sh.p.k, ka paraqitë propozim për caktimin e masës së sigurisë në Dhomën e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale. Propozimin e ka paraqitë së bashku me kërkesëpadi me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të të paditurës për shkak të kundërligjshmë të kontratës nr.613-23-40345-1-1/C799 si dhe kompensimin e dëmit.

Pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës së cilën veq e veq e edhe lidhshmërin e tyre Gjykata e Dhomës së Shkallës së Dytë ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, që do të thotë e ka vërtetuar aktvendimit të ankimuar, ngase gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka gjetur se propozimi është i pabazuar, e cila ka mbështetje ligjore si dhe janë dhënë arsyet e justifikushme të bazuara në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Kështu, edhe Dhoma e Shkallës së dytë thekson se nuk janë përmbush kushtet e parapara me nenin 297.1 nënpikë a) dhe b) për caktimin e masës së sigurisë ngase propozuesi nuk ka arrit të bëjë të besushëm kërkesën e saj e sidomos faktin se pa masën e sigurimit vështërohet në mënyrë të dukshme apo pamundësohet realizimi i kërkesëpadisë. Dhoma e Shkallës së dytë konsideron dhe thekson se po që se propozuesi e realizon kërkesëpadin e vet atëherë e realizon edhe shumën prej 33,602.00euro, të deponuar si garancion në rast të mosëpërmbushjes së kontratës edhe atë me kamatë ligjore nga dita e deponimit të padisë pranë gjykatës.

Andaj, në rastin konkret, kundërpropozuesi është institucion shtetëror dhe burimet e saja financiare janë nga buxheti i Republikës së Kosovës, kështu që realizimi i kërkesëpadisë së propozuesit nëse ajo vendoset me aktgjykim të formës së prerë janë qartësisht e realizueshme pa ndonjë vështërsi. E po që se propozuesi dështon të realizoi kërkesëpadin përmes gjykatës pse duhet garancioni ta humbë vlerën e vet financiar. Andaj e gjitha varet nga epilogu që do të mirret për çështjen kryesore.

Po ashtu Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoj pretendimet ankimore lidhur me shtyrje e seancës dëgjimore me të cilën ka refuzuar gjykata e shkallës së parë, por kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet të mjaftueshme në seancën e datës 26.04.2024 lidhur me mos shtyrjen e seancës ndëgjimore, të cilat e mbështet edhe kjo gjykatë, ngase e autorizuar e propozuesit në seancën e datë 16.04.2024 nuk ka kërkuar nga gjykata ndonjë ricaktim për datën tjetër me që ka qenë në njohuri për udhëtimin e saj gjysh në muajin Janar ashtu siq që shifet edhe nga fatura e pagesës së datës 30.01.2024, si dhe nga kjo faturë nuk dëshmohet asnjë rrethanë se e njehta nuk ka mundur të jetë prezentë në seancë, andaj një pretendim të till gjykatë e refuzoj si të pa bazuar. Po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendime tjera ankimore por nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje civile juridike.

Kështu, nga arsyet e cekura Dhoma e Shkallës së Dytë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 194, 209 paragrafi 1 pika (c) e lidhur 201 pika (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1112/2024, me datën 18.06.2024

Kryetare e kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri